



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 3 qershor 2015, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi dhe Valdete Bajrami.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kaçi, praktikante, Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Agim Krasniqi- zëvendësministër në Ministrinë e Financave, Kosum Aliu - Drejtor i NJQHAB në Ministrinë e Financave, Kaltrina Ahmeti - GLPS, Florina Merovci- ZPRK, Qëndresa Mulaj - ZAP, Emine Fazliu - ZAP, Ilir Abazi - ZAP, Artan Venhari - ZAP dhe Albana Meha - GLPS.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv.kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20.5.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit, për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integriteteve Evropiane, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014. I ftuar ministri i Ministrisë së Integriteteve Evropiane, Bekim Çollaku dhe zv. auditori i përgjithshëm z. Artan Venhari;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014. I ftuar ministri i Ministrisë së Financave z.Avdullah Hoti, dhe z.Kosum Aliu, drejtor në NJQHAB;
5. Të ndryshme.

Rend i ditës:

Zëvendëskryetari Ali Sadriu, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me ndryshime: Pika 3 dhe pika 4, hiqen nga rendi i ditës, për shkak të mospranisë së ministrave të ftuar për këtë takim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura më 20.5.2015;

Zv.kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.5.2015, me vërejtjen e deputetes Synavere Rysha, e cila tha se në pjesën ku ka të bëjë me shqyrtimin e raporteve vjetore të punës së agjencive të pavarura si dhe raporteve të auditimit të PVF-së, të audituara nga ZAP-i, nuk kam thënë që nuk duhet të shqyrtohen raportet e punës së institucioneve para raporteve të audituara, por kam thënë që nuk është mirë të shqyrtohen pa raporte të audituara.

3. Të ndryshme.

Ali Sadriu , zëvendëskryetar, i njoftoi deputetët se në këtë pikë do të trajtohen dy çështje. Auditimit i subjekteve politike, si dhe mosfunktionalizimi i njësisë së auditimit brenda Kuvendit për auditimin e agjencive të pavarura, e që nuk i plotësojnë kushtet për të pasur auditor të brendshëm dhe njësi të auditimit. Për të diskutuar për këtë çështje të ftuar janë: Sekretari i Përhershëm i Kuvendit z.Ismet Krasniqi dhe drejtori i Prokurimit në Kuvend. Kjo çështje ka lidhje me numrin e vogël të auditorëve të licencuar. Ligji thotë që për tu audituar subjektet politike duhet të zgjedhën së paku 10 auditorë të licencuar. Në Kosovë asnjë kompani nuk i ka në dispozicion më shumë se dy auditorë të licencuar, por gjithashtu dihet se në Kosovë janë diku mbi 60 auditorë të licencuar. Megjithatë, Kuvendi nuk ka arritur të përzgjedhë këta auditorë dhe se PVF-të e subjekteve politike për vitin 2013 dhe 2014, kanë mbetur të pa audituara.

Synavere Rysha- Ashtu siç parashihet me Ligjin për financimin e partive politike, duhet të veprohet edhe nga ana e KMFP-së. Këtu kërkohen 10 auditorë të licencuar, dhe se përzgjedhja e tyre do të bëhet me konkurs të hapur publik. Por nëse nuk mund të bëhet zgjidhja përmes konkursit të hapur publik, atëherë duhet të shikohen alternativa përmes procedurave të prokurimit. Mendoj se Ligji për financimin e partive politike nuk paraqet problem në këtë drejtim.

Xhemajl Halili theksoi se Drejtoria e Prokurimit vitin e kaluar ka bërë shpallje publike tri herë, megjithatë nuk ka arritur të sigurojë shërbimet e auditimit për subjektet politike. Kemi provuar të shkojmë edhe me procedurë të negociuar, megjithatë për këtë nuk është pajtuar Sekretari për shkak të rrezikut që mund të del nga procedura e negociuar. Unë personalisht kam komunikuar me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për interpretim ligjor të këtij neni dhe kemi marr aprovimin se procedurat kanë qenë në rregull, mirëpo, operatorët ekonomik nuk i kanë plotësuar kushtet tekniko administrative të dosjes së tenderit.

Aktualisht deri tani kemi zbatuar 5 procedura, por pa sukses. Sipas KRPP-së, përzgjedhja e 10 auditorëve mund të bëhet përmes konkursit pra si kontratë në vepër, për këtë kam edhe dëshmitë e komunikimin me KRPP-në.

Hajdar Beqa- Unë mendoj se në raste të tilla, Zyra e Prokurimit duhet ti drejtohet jo Zyrës Ligjore të Kuvendi, por Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), si organi më i lartë i prokurimit publik, që ta marrin mendimin se pse kemi pengesa në zgjidhjen e këtij problemi. Kur të shterohet edhe rruga e KRPP-së atëherë të vihet dhe të diskutohet në komision. Unë mendoj që Zyra e Prokurimit në Kuvend, në bashkëpunim me Sekretarin e Kuvendit duhet të kërkojë ndihmë nga ana e KRPP-së se si të veprohet në këtë rast.

Ismet Krasniqi theksoi se administrata e Kuvendit sipas rekomandimit të KMFP-së ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve për auditimin e subjekteve politike. Kemi hasur në disa çështje që brenda kompanive nuk po ka auditorë ligjor të mjaftueshëm, mirëpo, unë mendoj se ne duhet të përsërisim prapë me prokurim dhe nëse nuk bëhet me prokurim, atëherë të shkojmë edhe me konkurs dhe brenda buxhetit t'i zgjedhim këta operatorë ekonomikë për auditimin e raporteve financiare dhe të fushatës së subjekteve politike.

Adem Grabovci- Sipas Ligjit për financim të subjekteve politike, është dhënë shumë qartë mënyra dhe procedura që përmes konkursit të hapur publik të zgjidhen së paku 10 auditorë të licencuar për auditimin e subjekteve politike. Bazuar në këtë kërkojmë nga sekretari i Kuvendit të vazhdojë me procedurat për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e 10 auditorëve.

Kosum Aliu - Duhet të keni parasysh se auditorë ligjore janë të gjithë ata auditorë që licencën e kanë marrë nga ShKCAK (Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës) dhe janë të licencuar nga departamenti për standarde të raportimeve financiare, i Ministrisë së Financave. Po ashtu është shumë problem që brenda një kompanie audituese t'i gjeni 10 auditorë siç po kërkon. Një kompani audituese nuk ka më shumë se 2 auditorë ligjor.

Synavere Rysha- Mendoj se duhet të ketë standard të hartimit të raportit, po ashtu kujdes të shtuar në përcaktimin e kushteve të kontratës, dhe të bëhet një kategorizim i subjekteve të audituara, me kusht që një auditor të auditojë një vlerë të përafërt të mjeteve me auditorin tjetër.

Mendojë se parimet e përgjithshme të konkursit duhet ti përcaktojë Zyra e Sekretarit, ndërsa shortin duhet ta bëjë KMFP-ja.

Ali Sadriu- Në bazë të diskutimeve mund të vijmë në përfundim se KMFP-ja nuk ka nevojë të nxjerrë rekomandim shtesë nga ai që e ka pasur në fillim të vitit. E lusim Zyrën e Sekretarit t'i ndërmarrë të gjitha masat që të bëjë shpallje publike për aplikim, për përzgjedhjen e 10 auditorëve ligjor për auditimin e raporteve financiare dhe raporteve të deklaramit financiar të fushatës për subjektet politike, për vitin 2013 dhe 2014.

Përfundim

Administrata e Kuvendit të bëjë shpalljen e konkursit publik, për përzgjedhjen e 10 auditorëve të licencuar (ligjor) për auditimin e raporteve financiare dhe raporteve të deklaramit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2013 dhe 2014.

Ali Sadriu –Një çështje tjetër të cilën desha ta diskutojë me ju z.sekretar dhe me komisionin, është se, nga auditimet e jashtme të bëra për organizatat e ndryshme buxhetore, nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, KMFP-ja ka nxjerrë një përfundim që të formohet Njësia e Auditimit të Brendshëm brenda Kuvendit, mirëpo, kjo njësi nuk është bërë. Kjo kërkesë vjen për shkak që kemi shumë Agjenci dhe Zyra Rregullative të pavarura, që kanë nevojë për auditim, pavarësisht buxhetit të tyre. Po ashtu nga këto auditime të jashtme të ZAP-it, është vërejtur se në një numër të konsideruar të OB-ve nuk kanë njësi të auditimit dhe komitete të auditimit.

Ismet Krasniqi- Po ne kemi kërkuar për shtim të numrit të zyrtarëve nga Ministria e Financave si dhe nga ana e Kuvendit, mirëpo, për këtë nuk kemi gjetur mirëkuptim. Pastaj ka qenë problemi i dytë se cila do të jetë shuma e mjeteve të buxhetit të Agjencive që do të auditohen nga njësia e auditimit. A duhet të auditohen agjencitë që kanë më shumë se 500 mijë euro buxhet, apo ato që kanë më shumë së 1 milion euro buxhet, pra të vendosën kriteret se cilat agjenci duhet të auditohen. Këto janë arsytet që ne kemi ngecur që nga viti 2013, për formimin e njësisë së auditimit në Kuvend.

Kosum Aliu- Që nga viti 2012 dhe viti 2013, ne kemi dhënë rekomandimet në raportet vjetore ku i kemi rekomanduar Kuvendit të formojmë një njësi të përbashkët të auditimit të brendshëm ,

që ta ketë autoritetin ta bëjë auditimin e të gjitha agjencive që janë nën ombrellën e Kuvendit. Megjithatë kjo nuk ka ndodhur. Ekziston udhëzimi administrativ që përcakton kriteret se cilat njësi duhet bëjnë auditimin e Kuvendit. Ne jemi në fazën e rishikimit të këtij udhëzimi administrativ, ku po mendojmë që prapun prej 1 milion ta ngrisim, në mënyrë që të krijojmë një njësi profesionale të auditimit të brendshëm. Nuk mendoj se duhet të shkojmë në variantin që secila njësi shpenzuese të ketë njësi të auditimit dhe komitet të Auditimit, tëherë shpenzimet do të jenë shumë të larta.

Naim Fetahu theksoi se me qëllim që të mund të mbulohen agjencitë e pavarura në fushën e auditimit të brendshëm, nuk kishte me qenë e palogjikshme që brenda Kuvendit të krijohet një njësi për auditimin e agjencive të pavarura, që nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të pasur auditor të brendshëm.

Agim Krasniqi- Ne kemi biseduar si Ministri e Financave, për agjencitë e pavarura që kanë telashe me auditim, prokurim dhe me shërbime të përbashkëta, MF-ja është në shërbim të ju ndihmojë që të kenë shërbime të përbashkëta si në auditim, prokurim dhe financa, ngase me kapacitetin tonë buxhetor është problem që secila agjenci të ketë shërbimin bazë.

Artan Venhari- Ne kemi sugjeruar që për agjenci të pavarura, të cilat janë nën kontroll të Kuvendit, të ketë një njësi për t'i audituar ato, e ajo njësi të jetë brenda Kuvendit. Pra një auditor brenda kësaj njësie mund t'i auditojë disa agjenci, varësisht prej shumës së buxhetit të tyre.

Ismet Krasniqi- Sa i përket krijimit të kësaj njësie të auditimit të brendshëm brenda Kuvendit, doemos duhet të ketë aprovim nga KMFP-ja dhe nga Kryesia e Kuvendit.

Hajdar Beqa- Unë mendoj se është mirë që KMFP-ja të nxjerrë një rekomandim të ri për krijimin e njësisë së auditimit të brendshëm për auditimin e agjencive të pavarura. Ndërsa për çështjet e tjera teknike bisedojmë më vonë.

Synavere Rysha- Mendoj se është e palogjikshme që disa agjenci të kenë auditor brenda dhe disa në njësinë brenda Kuvendit. Ne po vendosim parime dhe po themi se të gjitha Agjencitë që i përgjigjen Kuvendit duhet të auditohen nga kjo njësi, sepse nëse i ndajmë atëherë nuk po

vendosim me kuti të barabartë. Unë mendoj se duhet të shikohet se a ka nevojë me u shkri agjencitë brenda ministrive, dhe se a ka nevojë me qenë gjitha këto borde.

Ali Sadriu- Nga kjo që u diskutua deri tani në mund të vijmë deri në një përfundim që administrata e Kuvendit të hulumtojë numrin e agjencive të pavarura që janë të themeluara nga Kuvendi dhe që i raportojnë Kuvendit, të cilat ende nuk kanë auditorë të brendshëm dhe që nuk kanë mundësi të themelojnë njësi të auditimit të brendshëm për shkak të kufizimeve të dhëna me udhëzim administrativ për auditim të brendshëm. Dhe ky rekomandim të shkojë në Kryesi të Kuvendit.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kërkon nga Administrata e Kuvendit, përkatësisht Zyra e Sekretarit, të na sjell një raport, se sa Agjenci të pavarura, të cilat i raportojnë Kuvendit, nuk kanë auditorë të brendshëm dhe nuk kanë të krijuara njësi të auditimit. Pas vlerësimit, të rekomandohet krijimi i njësisë së Auditimit të brendshëm brenda Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu